



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29.04.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
FERMERË

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej 150.000 €, për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

1. Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të subvencionimit dhe furnizimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit me serra në sipërfaqe prej 50m² sipas tabelës në vijim:

Furnizimi	Vlera
Serra në sipërfaqe prej 50 m ²	150,000 €
Gjithsej	150.000 €

Neni 3

Procedurat e blerjes së serrave, do të zhvillohen nëpërmjet procedurës së prokurimit publik.

Neni 4

Mënyra e përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nëpërmjet shpalljes publike për aplikim në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019.

Neni 5

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2021.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 15-400-21921

Lipjan, më 29.04.2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

